



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.228, datë 22.10.2019

PËR

SKUALIFIKIMIN DHE PËRJASHTIMIN E KANDIDATIT Z. {...}NGA PROCEDURA E EMËRIMIT NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 22.10.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur : *Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative.*

1.1 Me Vendimin nr.109, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur : *Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile.*

1.2 Me Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës penale”.*

1.3 Me Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :*shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile”.*

2. Brenda afatit të përcaktuar dyjavor nga dita e publikimit të vendimeve si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}ka aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurimit për pozicionet e lira të shpallura përmes vendimeve të mësipërme.

3. Me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë” (pika 1).* Po me këtë vendim (pika 2 - 22), pas shortit të hedhur, për procedurën e verifikimit për kandidatin, z. {...}, është caktuar si relator z. Alban Toro.

3.1 Me Vendimin nr. 182, datë 02.10.2019, bazuar në pikën 7, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, Këshilli I Lartë Gjyqësor, ndër të tjera, ka vendosur: *“Për kandidatët ... z. {...}, të cilët kanë aplikuar edhe për pozicionet shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019”.*

4. Më datë 26.07.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, njoftoi kandidatin për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi, të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtarit tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po

ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit tre ditor, kandidati depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Më datë 29.07.2019, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion ishte i mangët apo jo konform ligjit (origjinal ose i njëzuar me origjinalin), relatori i çështjes, në rrugë elektronike, njoftoi kandidatin për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

7. Po më datë 29.07.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, i dërgoi kandidatin formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesë ditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit.

9. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 06.08.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, relatori i çështjes kërkoi informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për z. {...}.

10. Po më datë 06.08.2019, në kuadër të verifikimit të kriterit të kandidimit *“të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”*, përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, neni 49 në lidhje me shkronjë “dh” të nenit 28, të Ligjit të Statusit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet shtetërorë dhe private që kanë mbikqyrur disiplinën në punë të kandidatis z. {...}, subjekte të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

11. Konkretisht, nga korrespondenca me Prokurorinë e Përgjithshme, sipas Shkresës nr. 2152 prot., datë 08.08.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor informohet se *“Nga të dhënat që ndodhen në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, për kandidatin për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, {...}, ju sqarojmë se: Me shkresën nr. 1872 prot., datë 22.11.2007, të kabinetit*

të Presidentit të Republikës, na është dërguar Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 5523, datë 22.11.2007, “Për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm {...}, për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksionit të tij”.

12. Ndërsa nga korrespondenca me Institucionin e Presidentit të Republikës, sipas Shkresës nr. 2794/1 prot., datë 09.08.2019, Këshillit të Lartë Gjyqësor i është dërguar Dekreti nr. 5523, datë 22.11.2007, “Për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm” dhe Letra e Presidentit të Republikës drejtuar deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.

13. Pas marrjes së informacioneve si më sipër, në funksion të verifikimit të tij, më datë 27.08.2019, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, iu kërkuan sqarime në lidhje me të dhënën e raportuar për disiplinën në detyrën e mbajtur më parë nga ai, atë të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

14. Më datë 29.08.2019, kandidati z. {...} parashtroi, në rrugë elektronike, sqarimet e tij.

15. Më tej, gjatë procedurës së verifikimit, po në funksion të verifikimit dhe plotësimit të informacionit si më lart, është realizuar një korrespondencë me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

16. Kështu, nga korrespondenca me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas Shkresës nr. 3034/1 prot., datë 02.09.2019, Këshillit të Lartë Gjyqësor i është dërguar Vendimi nr. 141, datë 05.11.2007, i Kuvendit të Shqipërisë, “Për miratimin e raportit përfundimtar të komisionit hetimor “Për shqyrtimin e kërkesës për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, ngritur me Vendim të Kuvendit nr. 135, datë 25.10.2007”.

17. Ndërsa nga korrespondenca me Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë, sipas Shkresës nr. 280/1 prot., datë 04.09.2019, Këshillit të Lartë Gjyqësor i është dërguar Vendimi nr. 21, datë 01.10.2008, i Gjykatës Kushtetuese, marrë mbi kërkesën e kërkuesit {...}, me objekt “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 141, datë 05.11.2007, të Kuvendit të republikës së Shqipërisë. 2. Shfuqizimi si antikushtetues i Dekretit nr. 5523, datë 22.11.2007, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë”.

18. Pas të dhënave të grumbulluara në lidhje me faktin e shkarkimit të kandidati z. {...} nga detyra e Prokurorit të Përgjithshëm, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet e nenit 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi vlerësimin se në rastin konkret verifikohet një rrethanë që mund të çonte në përfundimin se kandidati nuk plotësonte një nga kriteret e emërimit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, relatori i çështjes vuri në dijeni Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, i cili, mbështetur në shkronjën “a”, pika 12, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, me Vendimin e datës 19.09.2019, vendosi që: “Kandidati z. {...} të ftohet për

të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij”.

19. Mbi këtë bazë, më datë 19.09.2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, njoftoi kandidatin për gjetjen e procedurës së verifikimit, pra në lidhje me kushtin e kandidimit “*nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi*”, duke e ftuar për të paraqitur shpjegime për gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe çdo dokumentacion mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij.

20. Brenda afatit pesë ditor, pikërisht më datë 23.09.2019, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, paraqiti shpjegimet e tij ku ndër të tjera parashtron se:

“...Omissis... 1. Në lidhje përsa më kërkohet nga ana juaj me emailin e datës 19.09.2019, po ju paraqes opinionin tim si më poshtë vijon: Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 21, datë 01.10.2008 shprehet për çështjen e parashtruar para saj nga ish Prokurori i Përgjithshëm {...} se: “Neni 131/f i Kushtetutës në lidhje me nenin 134/1/g të saj, i jep të drejtë individit të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave, d.m.th, pasi individi të jetë drejtuar e të ketë marrë përgjigje nga organet e tjera kompetente shtetërore. Në rastin e kërkesave kundër vendimit të Kuvendit dhe përkatësisht të dekretit të Presidentit për shkarkimin nga detyra, kërkesit nuk mund të vënë në lëvizje ndonjë organ tjetër shtetëror për shqyrtimin e tyre veç Gjykatës Kushtetuese, sepse asnjë prej organeve të tjera shtetërore nuk ka në kompetencë shqyrtimin e këtyre kërkesave. Sipas neneve 324 e 333 të Kodit të Procedurës Civile nuk mund të shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme aktet me karakter administrativ, të cilat janë rezultat i procedurave parlamentare. Këtë qëndrim mban edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.76, datë 25.04.2002 sipas të cilit dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, si një akt individual me karakter administrativ, nuk mund të trajtohet në të njëjtën mënyrë si aktet e tjera administrative, të cilat shqyrtohen nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Veçantia e këtij dekreti të Presidentit të Republikës qëndron në faktin, se ai është i lidhur pazgjidhshmërisht me procedurat parlamentare në bazë të cilave ka dalë vendimi i Kuvendit që është një premisë e domosdoshme për nxjerrjen e dekretit. Ndërsa në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës në lidhje me interpretimin e bërë në vendimin e saj nr.76, datë 25.04.2002, verifikon pretendimin e individit se gjatë zbatimit të procedurës për shkarkimin e tij nga Kuvendi e Presidenti nuk është respektuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës sipas të cilit, liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të tillë ligjor. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese nuk i hyn themelit të çështjes, pra vlerësimit të shkaqeve të shkarkimit dhe as shfuqizon aktet e Kuvendit e Presidentit për çdo shkelje të procedurave, por i shfuqizon ato vetëm kur konstaton se nuk janë respektuar parimet procedurale në atë masë që të sigurojnë respektimin e së drejtës për një proces të rregullt në kuptimin kushtetues.

2. Dekreti nr. 5523, datë 22.11.2007 i Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe vendimi i Kuvendit nr.141, dt. 05.11.2007, janë ankimuar prej meje në Gjykatën Kushtetuese. Sikundër parashtrohet në pjesët e cituara më lart të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit nuk i ka hyrë shqyrtimit të themelit të çështjes, por vetëm shqyrtoi nëse kishte apo jo cenim të procesit të rregullt ligjor (e drejta për t'u dëgjuar, për t'u njohur me materialet, etj.) dhe konkludoj me shumicën e votave të anëtarëve të saj, se në rastin e shkarkimit ishte respektuar e drejta e Prokurorit të Përgjithshëm për t'u dëgjuar nga Kuvendi. Në asnjë rresht të vendimit të saj nuk shqyrtoi themelin, përkundrazi theksoi mëse njëherë se sipas neneve 324 e 333 të Kodit të Procedurës Civile nuk mund të shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme aktet me karakter administrativ, të cilat janë rezultat i procedurave parlamentare. Ky ishte një qëndrim i përsëritur i Gjykatës Kushtetuese i njëjtë me atë të dhënë në vendimin nr.76, datë 25.04.2002 sipas të cilit dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, si një akt individual me karakter administrativ, nuk mund të trajtohet në të njëjtën mënyrë si aktet e tjera administrative, të cilat shqyrtohen nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

3. Ndërkohë gjithashtu ju parashtroj se nga ana ime në cilësinë e Prokurorit të Përgjithshëm është kërkuar nga Gjykata Kushtetuese zgjidhja e mosmarrëveshjeve të kompetencave ndërmjet Kuvendit dhe institucionit të prokurorisë dhe në përfundim Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 26, dt. 04.12.2006, vendosi që "Kuvendi nuk ka kompetence të kontrollojë dhe të vlerësojë vendimmarrjen e prokuroreve në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq ...". Ende edhe sot ky vendim qëndron në themel të jurisprudencës kushtetuese dhe shërbeu si bazë solide edhe për reformën në drejtësi të ndërmarrë së fundmi nga Kuvendi i Shqipërisë.

4. Sjell në vëmendjen tuaj që shkarkimi im nga detyra e Prokurorit të Përgjithshëm është paraprirë nga një fushatë sulmesh politike nga mazhoranca e kohës, që vazhdoi me ngritjen e komisionit hetimor nga Kuvendi me vendimin nr. 31, datë 02.05.2006, dhe me propozimin për shkarkim drejtuar Presidentit të Republikës, por që shkarkimi u refuzua nga ky i fundit në datën 13.10.2006. Lufta e ashpër politike dhe argumentet - që mund të kishin lidhje me çdo gjë por vetëm me ligjin jo- u pasqyruan intensivisht në shtypin dhe median e kohës. Në kohën e vështirë kur {...} dhe familja e tij u vendos në qendër të një lufte të ashpër politike, unë zgjodha rrugën e përballje me argument të ligjore dhe ndjekjes së rrugës së ankimit në Gjykatën Kushtetuese, dhe jo atë të dorëheqjes për rehati personale, pavarësisht se "ofertat" për të dhënë dorëheqje me drejtoheshin në mënyrë të përsëritur. Pra, shkarkimi im nga detyra e Prokurorit të Përgjithshëm nuk është bërë për shkaqe disiplinore, por për shkaqe politike, dhe natyra e shkarkimit është e njëjtë me atë të "impeachmentit". Askush nuk mund të akuzohet se ka shkelur disiplinën e punës, në një kohë që nuk i lejohet ankimi për çështjen në themel në gjykatë për të shqyrtuar nëse shkaqet e pretenduara si shkelje qëndrojnë apo jo.

Bazuar sa më sipër, edhe duke qene se vendimi i shkarkimit tim nga detyra e Prokurorit të Përgjithshëm është marrë në datën 22.11.2007, pra afërsisht 12 vjet përpara momentit të

aplikimit tim, masa disiplinore konsiderohet ligjërishit e shuar dhe nuk prodhon asnjë pasojë juridike për procedurën që Këshilli i Lartë Gjyqësor është duke kryer.

Përfundimisht gjykoj se që të konsiderohet një person se është shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore, ai minimalisht duhet te gëzojë të drejtën ta kundërshtojë shkarkimin në gjykatë. Prokurori i Përgjithshëm nuk e kishte këtë mundësi për thelbin. Sepse shkarkimi i tij ishte përmes një procesi politik nga një organ politik. Në respekt të jurisprudencës kushtetuese, Prokurori Përgjithshëm kishte mundësi të godiste aktin e shkarkimit vetëm për (pa)rregullsinë e procesit, por jo për thelbin. ...omissis...”

21. Pas marrjes së shpjegimeve nga kandidati, duke vlerësuar të plota procedurën e verifikimit të ndjekur deri në këtë moment dhe, në veçanti, verifikimet në lidhje me kushtin e kandidimit “*nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi*”, mbi konsideratën se në rastin konkret verifikohet një rrethanë që ishte e aftë për të pasjellë skualifikimin e kandidatit nga procedura e emërimit, relatori i çështjes ia parashtrroi rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

22. Në mbledhjen e datës 01.10.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plota procedurat dhe verifikimet për këtë kusht kandidimi për z. {...}, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për skualifikimin e kandidatit për mosplotësimin e këtij kushti kandidimi ose për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

II. GJETJA E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT DHE VLERËSIMI I SAJ

23. Pas administrimit të dokumentacionit ligjor dhe në mënyrë të veçantë nga shpjegimet e detajuara që ka dhënë kandidati z. {...}, referuar Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si pjesë e paketës ligjore për reformën në drejtësi, i cili përmban rregullime jo vetëm mbi të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit, vlerësimin etik dhe profesional, përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile, por edhe për kriteret e rekrutimit të tyre në sistemin gjyqësor në përgjithësi dhe, në mënyrë të veçantë në Gjykatën e Lartë, konkretisht referuar shkronjës “dh”, të nenit 28, e cila kërkon që kandidati të përmbush njëkohësisht edhe kriterin “*nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi*”, u konstatua se ekziston një rrethanë që nuk lejon kualifikimin për emërim, sepse nga kandidati nuk përmbushet ky kriter kandidimi/emërimi.

24. Me konkretisht, në nenin 136 të Kushtetues së Republikës së Shqipërisë, ndër të tjera, përcaktohet se: “3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtareve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtareve në këtë gjykatë përzgjidhen mes juristeve të spikatur me jo me pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektore të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatet që përzgjidhen nga radhët e juristeve duhet të kenë grade shkencore në drejtësi. 4.

Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohet me ligj...omissis”. Siç rezulton nga interpretimi i fjalisë së dytë, të pikës 4, të dispozitës Kushtetuese, kjo e fundit pasi ka përcaktuar kushtet që duhet të gëzojë kandidati jogjyqtar (juristi i spikatur) në konkurimin e tij për në Gjykatën e Lartë, ka autorizuar ligjvënësin të përcaktojë kritere të tjera që kandidati duhet të përmbush për të kandiduar dhe emëruar në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë.

25. Ndërkohë, në nenin 49 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjvënësi ka përcaktuar kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë nga radhët e jogjyqtarëve, duke parashikuar se: “*Omissis ... 2) Kandidatët jo gjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të nenit 28, të këtij ligji; ... 5) Këshilli vlerëson përmbushjen e kriterëve, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, dhe verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. Kandidatët, të cilët nuk përmbushin kriteret ose nuk kalojnë procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi”.*

26. Nisur nga fakti që vërtetohet, si dhe në referim të ligjit të zbatueshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati z. {...} nuk plotëson një nga kriteret e kandidimit/emërimit në Gjykatën e Lartë, pikërisht atë të përcaktuar në nenin 28, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, atë “*nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore”.*

27. Po ashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të rregullta dhe të plota procedurat e verifikimit të ndjekura deri në këtë moment për kandidatin z. {...}, në veçanti verifikimet sa i përket këtij kriteri kandidimi.

III.PRETENDIMET E KANDIDATIT DHE VLERËSIMI I TYRE

28. Në shpjegimet e tij, kandidati, z. {...}, ndër të tjera, ka parashtruar se :

“...Omissis... Përsa kërkoni ju informoj se:

Dekreti nr. 5523, dt. .22.11.2007, i Presidentit të Republikës, nuk është ankimuar në gjykatë, pasi sipas neneve 324 e 333 të K. P. Civile (të kohës) dhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese aktet me karakter administrativ të cilat janë rezultat i procedurave parlamentare nuk mund të shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme. Dekreti në fjalë, si dhe vendimi i Kuvendit nr.141, dt. 05.11.2007, janë ankimuar në Gjykatë Kushtetuese nga ana ime, kërkesë e cila është rrefuzuar, me argumentin se edhe kjo gjykatë nuk ka të drejtë t'i hyjë themelit të çështjes (d.m.th. qëndrojnë apo jo shkaqet e shkarkimit). Gjykata kushtetuese shqyrtoi vetëm faktin nëse kishte apo jo cenim të parimit të procesit të rregullt ligjor në procedurën e shkarkimit të prokurorit të përgjithshëm, duke konkluduar se në tërësi ky parim është respektuar nisur nga fakti që Prokurori i Përgjithshëm është dëgjuar nga ana e Kuvendit. (shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, dt. 01.10.2008)

Ndërkohë, nga ana ime si Prokuror i Përgjithshëm, është kërkuar nga Gjykata Kushtetuese zgjidhja e mosmarrëveshjeve të kompetencave ndërmjet Kuvendit dhe institucionit të prokurorisë dhe në përfundim Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr26, dt. 04.12.2006, vendosi që " Kuvendi nuk ka kompetence të kontrollojë dhe të vlerësojë vendimmarrjen e prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq ...".

Sjell në vëmendjen tuaj që shkarkimi im nga detyra e prokurorit të përgjithshëm është paraprirë nga një fushatë sulmesh politike nga mazhoranca e kohës, që vazhdoi me ngritjen e komisionit hetimor nga Kuvendi me vendimin nr.31, dt. 02.05.2006 , dhe me propozimin për shkarkim drejtuar Presidentit të Republikës, por që shkarkimi u refuzua nga ky i fundit në dt. 13.10.2006.

Në lidhje sa më sipër, kuptoj që ju jeni duke verifikuar nëse nga ana ime kënaqen kërkesat e nenit 49 në lidhje me nenin 28, "dh" të ligjit 96/2016, pra "a jam larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, dhe se a kam masë disiplinore në fuqi".

Unë vlerësoj së shkarkimi im nga detyra e prokurorit të përgjithshëm nuk është bere për shkaqe disiplinore, por për shkaqe politike, dhe natyra e shkarkimit është e njëjtë me atë të "Impeachmentit". Askush nuk mund të akuzohet se ka shkelur disiplinën e punës, në një kohë që nuk i lejohet ankimi në gjykatë për të shqyrtuar nëse shkaqet e pretenduara si shkelje qëndrojnë apo jo.

Veç sa sipër, duhet marre në konsideratë fakti që shkarkimi ka ndodhur në vitin 2007, pra 12 vjet me parë, dhe sipas ligjit "Për shërbimin civil ..." me kalimin e 7 vjetëve nga masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, ajo quhet e parashkruaromissis..".

29. Këshilli i Lartë Gjyqësor duke u mbështetur në dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi, të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, vlerëson se kandidati z.{...} duhet të skualifikohet dhe përjashtohet nga procedurat e emërimit për katër pozicionet e lira të shpallura për në Gjykatën e Lartë. Në këtë konkluzion Këshilli arrin në vlerësim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, frymës dhe qëllimit të ligjbërësit në lidhje me përzgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

30. Nga interpretimi i dispozitave kushtetuese dhe ligjore të posaçme, ***lex specialis***, rezulton se ligji material ka përçuar qëllimin e kushtetutbërësit për transformimin e Gjykatës së Lartë “*në një gjykatë karriere përmes vendosjes së kriterëve transparente për emërimin e gjyqtarëve nga të dy kategoritë (gjyqtar dhe jogjyqtar/juristë të spikatur)*” për të garantuar një përbërje cilësore, jo vetëm nga pikëpamja profesionale, por në veçanti edhe sa i përket integritetit dhe figurës. Përmes vendosjes së kushteve dhe kriterëve ligjore të emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë synohet identifikimi dhe përzgjedhja e profesionistëve në fushën e drejtësisë, të cilët të kenë aftësi të spikatura sipas kategorive të saj, për njëherazi edhe një integritet të lartë moral, sepse suksesi i vërtetë i çdo gjykate, në veçanti i Gjykatës së Lartë, si organi më i lartë i pushtetit gjyqësor, varet nga kompetenca profesionale dhe integriteti moral i çdo gjyqtari, si ushtrues të drejtpërdrejtë të pushtetit gjyqësor në funksion të dhënies së drejtësisë raste individuale dhe veçanërisht për kuptimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit me qëllim për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

31. Ligji i posaçëm, Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 28, shkronja “dh”, parashikon si kriter zgjedhshmërie, për pranimin në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe, më tej, për rekrutimin e gjyqtarit, mosqenien e kandidatit *“i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore”*, si dhe *“mospasjen masë disiplinore në fuqi”*. Ky kriter zgjedhshmërie është konsideruar nga ligji i posaçëm, neni 49, pika 2, shkronja “a”, edhe për kandidatët për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

32. Duke ardhur ne rastin konkret jemi para faktit që kandidati z. {...}, ndërsa ka qenë në ushtrim të funksionit të lartë publik të Prokurorit të Përgjithshëm, me vendim të organit kompetent kushtetues të ngarkuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (sipas rregullimeve të kohës, nenit 149, pika 2), pikërisht të Presidentit të Republikës, mbi propozimin e organit kompetent kushtetues të ngarkuar po nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (sipas rregullimeve të kohës, nenit 149, pika 2), pikërisht të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, është shkarkuar nga detyra *“për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij”*.

32.1 Konkretisht, kandidati z. {...} provohet të ketë mbajtur funksionin e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë gjatë periudhës 2002 - 2007. Ai është emëruar në këtë funksion nga Presidenti i Republikës me pëlqimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ndërsa ka filluar zyrtarisht ushtrimin e funksionit në Mars 2002.

32.2 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me Vendimin nr.135, datë 25.10.2007, bazuar në Ligjin nr.8891, datë 02.05.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, krijoi një Komision Hetimor për verifikimin e pretendimeve të ngritura nga një grup deputetësh për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm z. {...}. Vendimi i Kuvendit për krijimin e Komisionit Hetimor në këtë rast është marrë pas shqyrtimit paraprak të kërkesës së një grupi nismëtar deputetësh në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ku janë dëgjuar edhe deklaratimet e Prokurorit të Përgjithshëm lidhur me bazueshmërinë në ligj e në prova të kërkesës së deputetëve.

32.3 Pas procedurës hetimore të ndjekur nga Komisioni Hetimor, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë mori në shqyrtim në seancë plenare raportin e këtij Komisioni, ndërsa ka dëgjuar edhe Prokurorin e Përgjithshëm z. {...}. Në përfundim të shqyrtimit, me Vendimin nr.141, datë 05.11.2007, Kuvendi vendosi të miratojë raportin e Komisionit Hetimor me titull *“Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm”* dhe t’ia dërgojë atë Presidentit të Republikës.

32.4 Presidenti i Republikës së Shqipërisë në këtë rast ka dëgjuar pretendimet e Prokurorit të Përgjithshëm z. {...}, duke i ballafaquar ato me dokumentet dhe gjithë praktikën e Komisionit Hetimor të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Po ashtu, Presidenti ka dëgjuar edhe mendimin e një komisioni ekspertësh të ngritur prej tij. Në përfundim të shqyrtimit të propozimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës, me Dekretin nr.5523, datë

22.11.2007, ka vendosur “Shkarkimin nga detyra e Prokurorit e Përgjithshëm, të z.{...}, për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksionit të tij”.

32.5 Ndaj vendimmarrjeve si më sipër, pra Dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr.5523, datë 22.11.2007 dhe Vendimit nr.141, datë 05.11.2007, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, z.{...} ka ushtruar ankim në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese, me Vendimin nr.21, datë 01.10.2008, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës. / Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.”

32.5.1 Në vendimin e saj, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, ndër të tjera, ka konkluduar se:

“...kërkuesi legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën si të vendimit të Kuvendit, ashtu edhe të dekretit të Presidentit për shkarkimin e tij nga detyra.

Neni 131/f i Kushtetutës në lidhje me nenin 134/1/g të saj, i jep të drejtë individit të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor pasi të jenë shterruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave, d.m.th, pasi individi të jetë drejtuar e të ketë marrë përgjigje nga organet e tjera kompetente shtetërore. Në rastin e kërkesave kundër vendimit të Kuvendit dhe përkatësisht të dekretit të Presidentit për shkarkimin nga detyra, kërkuesit nuk mund të vënë në lëvizje ndonjë organ tjetër shtetëror për shqyrtimin e tyre veç Gjykatës Kushtetuese, sepse asnjë prej organeve të tjera shtetërore nuk ka në kompetencë shqyrtimin e këtyre kërkesave.

Sipas neneve 324 e 333 të Kodit të Procedurës Civile nuk mund të shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme aktet me karakter administrativ, të cilat janë rezultat i procedurave parlamentare. Këtë qëndrim mban edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.76, datë 25.04.2002 sipas të cilit dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, si një akt individual me karakter administrativ, nuk mund të trajtohet në të njëjtën mënyrë si aktet e tjera administrative, të cilat shqyrtohen nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Veçantia e këtij dekreti të Presidentit të Republikës qëndron në faktin, se ai është i lidhur pazgjydhshmërisht me procedurat parlamentare në bazë të të cilave ka dalë vendimi i Kuvendit që është një premisë e domosdoshme për nxjerrjen e dekretit”. Dekreti i kundërshtuar në këtë gjykim është i tillë. Ai është rezultat i procedurave parlamentare në bazë të të cilave është kërkuar shkarkimi i Prokurorit të Përgjithshëm, pasi është miratuar komisioni hetimor dhe është miratuar raporti i këtij komisioni me propozimin për shkarkim që i bëhet Presidentit të Republikës.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin e mësipërm, ka pranuar gjithashtu, se cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës sjell cenimin e realizimit të të drejtave të tjera kushtetuese e ligjore. Për këtë arsye, mbrojtja kushtetuese realizohet në rastin e të gjitha konflikteve që janë vendimtare për pozicionin juridik të një personi, goftë ai edhe funksion publik, duke e parë funksionin e funksionarit publik në këndvështrimin e garancive që ia siguron Kushtetuta dhe jurisprudenca e kësaj gjykate. Në këtë drejtim nuk bëhet pengesë as Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut. Kjo e fundit vendos standardet e domosdoshme dhe kufirin minimum të mbrojtjes së të drejtave e lirive themelore, por ajo nuk

pengon që shtetet anëtare të vendosin standardet e kufij më të përparuar për mbrojtjen e të drejtave.

... Gjykata Kushtetuese vlerëson, se sipas nenit 149/2 të Kushtetutës, **Presidenti i Republikës është organi që vendos për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm kur arrin në përfundimin se ky i fundit ka shkelur Kushtetutën ose ka bërë shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, ka kryer akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e Prokurorit ose ka paaftësi mendore a fizike.** Në këto raste, **Presidenti i Republikës**, (ashtu si edhe Gjykata Kushtetuese në rastet e parashikuara në nenet 90/3, 128 e 140 të Kushtetutës, kur shqyrton shkaqet e shkarkimit të Presidentit të Republikës, të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese e të anëtarit të Gjykatës së Lartë), **verifikon jo vetëm kushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur për shkarkimin e tyre, por edhe bazueshmërinë në Kushtetutë të shkaqeve të shkarkimeve, pra i futet çështjes në themel.** Ndërsa në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës në lidhje me interpretimin e bërë në vendimin e saj nr.76, datë 25.04.2002, verifikon pretendimin e individit se gjatë zbatimit të procedurës për shkarkimin e tij nga Kuvendi e Presidenti nuk është respektuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës sipas të cilit, liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të tillë ligjor. Në këtë rast **Gjykata Kushtetuese nuk i hyn themelit të çështjes, pra vlerësimit të shkaqeve të shkarkimit dhe as shfuqizon aktet e Kuvendit e Presidentit për çdo shkelje të procedurave, por i shfuqizon ato vetëm kur konstaton se nuk janë respektuar parimet procedurale në atë masë që të sigurojnë respektimin e së drejtës për një proces të rregullt në kuptimin kushtetues.**

Kërkuesi pretendoi, se Kuvendi dhe Presidenti i Republikës kanë zhvilluar proces jo të rregullt, pasi nuk e kanë njohur me provat/faktet që përlligjin shkaqet kushtetuese të shkarkimit nga detyra. Sipas tij, provat nuk i janë nënshtruar hetimit nga Komisioni Hetimor, por janë konsideruar të mirëqena.

... Gjykata Kushtetuese konstaton, se në përputhje me rregulloren e Kuvendit, kërkuesi është ftuar të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit të Kuvendit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në datën 17.10.2007, datë në të cilën u shqyrtua kërkesa e 28 deputetëve (1/5 e gjithë deputetëve të Kuvendit) për ngritjen e një komisioni hetimor për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm. Me kërkesën e kërkuesit, Komisioni ka pranuar shtyrjen e seancës dhe në datën 22.10.2007 kërkuesi ka parashtruar pretendimet e tij para këtij Komisioni. Për shqyrtimin e çështjes nga ky Komision, kërkuesi nuk pati ndonjë pretendim.

... Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se **Komisioni Hetimor nuk i ka mohuar kërkuesit të drejtën për t'u njohur me materialet e shqyrtuara nga Komisioni dhe as të drejtën për të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit, për të paraqitur provat e veta dhe për të provuar pretendimet e tij.** Në respektim të Rregullores së Kuvendit, të Ligjit nr.8891, datë 02.05.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit", si dhe të rregullave të Kodit të Procedurës Penale, kërkuesi duhej t'i përgjigjej ftesës që i bëri Komisioni Hetimor për t'u dëgjuar prej këtij të fundit, ku do të njihej më mirë dhe me provat e administruara nga Komisioni. Jo vetëm kaq, por ai ishte i njohur më parë me shkaqet e problemet për të cilat grupi nismëtar i deputetëve do të bënte hetime dhe lidhur me këto, edhe me një pjesë të mirë të dokumenteve mbi të cilat ky grup i bazonte shkaqet për shkarkim.

... Nga përmbajtja e dokumenteve të mësipërme, nga pretendimet e parashtruara prej kërkuesit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, nga raporti përfundimtar i Komisionit Hetimor dhe sidomos nga fjala që ka mbajtur kërkuesi në Kuvend del qartë se ai ishte në dijeni jo vetëm për akuzat e ngritura kundër tij, por edhe për përmbajtjen e provave mbi të cilat Komisioni mbështeste konkluzionin e vet për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Për më tepër, me këto prova, të specifikuar edhe në raportin përfundimtar të Komisionit, Prokurori i Përgjithshëm ishte njohur nga korrespondenca dhe rrugët e tjera të komunikimit të këtij organi me ministrinë dhe organet e tjera.

... Nga fjala e kërkuesit në Kuvend si dhe nga shkresat e datave 29.10.2007 e 16.11.2007 që kërkuesi i ka dërguar Presidentit të Republikës, del se **kërkuesi jo vetëm është njohur me problemet e dokumentet ku mbështetet Komisioni i Kuvendit, por ka dhënë dhe përgjigje të hollësishme në Kuvend lidhur me shkeljet e pretenduara në raport, duke i kundërshtuar ato si në aspektin faktit ashtu edhe juridik.**

... Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi, pasi është njohur me raportin e Komisionit Hetimor, me pretendimet e këtij Komisioni për shkeljet e konstatuara prej tij dhe me provat ku ai bazohet, ka parashtruar në seancën plenare të Kuvendit pretendimet e tij pa kufizim kohe. Nga fjala e mbajtur prej tij del se ai ka dhënë përgjigje të argumentuara për të gjitha shkeljet që i atribuoheshin dhe lidhur me pretendimet e parashtruara prej tij janë zhvilluar diskutimet e debatet. **Nuk rezulton që kërkuesit t'i kenë mohuar të drejtën për të paraqitur argumentet e provat e veta apo për të kundërshtuar akuzat.**

Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin që **nuk është i bazuar as pretendimi i kërkuesit se dekreti i Presidentit është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Presidenti i Republikës është njohur me pretendimet e kërkuesit në dy shkresat e lartpërmendura që ia ka dërguar kërkuesi. Duke i ballafaquar këto pretendime me gjithë veprimtarinë dhe praktikën e ndjekur nga komisionet dhe Kuvendi ai arriti në përfundimin se kërkuesi duhet të shkarkohet nga detyra. Ky qëndrim është në të njëjtën linjë me atë që theksohet në vendimin nr.75, datë 19.04.25002 të Gjykatës Kushtetuese, se “Presidenti i Republikës është organi kompetent i ngarkuar nga Kushtetuta për të kryer verifikimin nga pikëpamja kushtetuese të shkaqeve si dhe të procedurave të ndjekura nga Kuvendi për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm”. Për Gjykatën Kushtetuese, që shqyrton një ankesë individuale për shkeljen e të drejtave kushtetuese për një proces jo të rregullt ligjor, objekt shqyrtimi nuk janë verifikimet e vërtetësisë, rëndësisë së shkeljeve dhe as interpretimi i ligjit në lidhje me shkakun e shkarkimit, pra me zgjidhjen në themel të çështjes. Në çështjen në shqyrtim, për Gjykatën Kushtetuese, objekt është respektimi edhe nga Presidentit i së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.**

Duke i parë problemet në këtë këndvështrim, dalin tej kontrollit kushtetues të kësaj gjykate verifikimi i pretendimeve të kërkuesit për pathemelësinë e akuzave lidhur me ekstradimet, me mosekzekutimin e urdhrave të arrestit etj. Verifikimi i tyre dhe nxjerrja e konkluzioneve lidhur me përgjegjësinë kushtetuese të Prokurorit të Përgjithshëm është kompetencë e Kuvendit dhe e Presidentit të Republikës, që buron nga neni 149 i Kushtetutës.

... Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve, Gjykata Kushtetuese ka dhënë përgjigje dhe ka përcaktuar kufijtë e kompetencave, në mosmarrëveshje midis Kuvendit dhe Prokurorisë, në vendimet nr.26, datë 04.12.2006 dhe nr.12, datë 20.05.2008.

Por, në çështjen në shqyrtim, pa hyrë në vlerësimin e konkluzioneve të Kuvendit, konstatohet se kontrolli i Komisionit Hetimor nuk i ka kapërcyer kufijtë e kompetencave të veta përsa i përket konstatimit të mosveprimtarisë për lirin e të dënuarve për dënime të rënda apo analizës së drejtimeve kryesore të politikës penale.

... Kërkuesi pretendon gjithashtu, se gjatë hetimit të zhvilluar nga Komisioni Hetimor i Kuvendit dhe deri tek shpallja e dekretit të Presidentit të Republikës, atij i është mohuar e drejta kushtetuese për t'u prezumuar i pafajshëm duke u cenuar njëkohësisht edhe parimi i gjykimit nga një organ i paanshëm. Si argument për të vërtetuar këtë pretendim ai parashton faktin që disa nga deputetët që kanë kërkuar ngritjen e komisionit të dytë hetimor janë po ata që janë përfshirë në përbërje të këtij komisioni apo të komisionit të mëparshëm hetimor si dhe faktin, që Presidenti i Republikës që dekretoi shkarkimin kishte votuar në shqyrtimin e mëparshëm nga Kuvendi për marrjen e vendimit të propozimit për shkarkimin e tij nga detyra.

... Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme të shprehë vlerësimet e saj lidhur dhe me natyrën e shqyrtimit të çështjeve të shkarkimit të funksionarëve nga Kuvendi e Presidenti si dhe të raportit që këto organe kanë midis tyre.

Komisionet parlamentare, në rastet e shkarkimit të funksionarëve kushtetues zhvillojnë procedura “quazi gjyqësore” dhe respektojnë parimet e procesit të rregullt ligjor për aq sa ua lejon mundësia e shqyrtimit për të marrë një vendim, i cili është me karakter politiko administrativ dhe jo gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr.18/2003 është shprehur, se në këto raste, Kuvendi duhet të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë, ndërsa në vendimin nr.75, datë 19.04.2002 ka pranuar gjithashtu, se funksioni që kryen Kuvendi në rastet e verifikimit të shkaqeve për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm ndryshon nga gjithë veprimtaria e tij e zakonshme si një organ që miraton ligje. Ky proces, sipas atij vendimi, është “një proces gjykimi disiplinor dhe i ngjashëm me procedurat hetimore administrative, ka parimet e veta, të cilat lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e atyre shkaqeve konkrete që kanë shërbyer për organin kompetent për të marrë masën e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit apo të prokurorit”.

Megjithatë, edhe në rastet e gjykimit të funksionarëve të lartë kushtetues parimet e prezumimit të pafajësisë dhe ai i paanshësisë nuk mund të zbatohen si parime tipike klasike të proceseve gjyqësore, sepse Parlamenti, qoftë në përbërjen dhe organizimin e vet, qoftë në veprimtarinë e funksionin e tij, nuk ka si të jetë organ gjyqësor. Parlamenti, në një procedurë shkarkimi nuk ushtron pushtet gjyqësor, por një pushtet tjetër e të ndryshëm, që në mënyrë ekskluzive i është deleguar atij. Prandaj, ky organ mund të zbatojë parimin e paanshësisë në një mënyrë tipike kushtetuese d.m.th. për aq sa nuk e pengon të ushtrojë kompetencat e veta për të nxjerrë një akt administrativ që ka njëkohësisht edhe një natyrë kushtetuese.

Në këndvështrim të neneve 2, 3 e 64 të Kushtetutës, Kuvendi përbëhet nga përfaqësues të popullit, ka një përbërje pluraliste politike dhe vendimet e tij merren me shumicën e votave. Kjo përbërje pluraliste politike konkretizohet edhe në përbërjen e komisioneve.

Prerogativa e Kuvendit për paraqitjen e propozimit për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe ajo e Presidentit të Republikës për të dekretuar shkarkimin e tij, të

parashikuara në nenin 149 të Kushtetutës, realizohen nëpërmjet një procedure që disiplinohet edhe nga Ligji nr.8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, nga Rregullorja e Kuvendit dhe nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por në asnjë prej këtyre burimeve që dispijlojnë këtë procedurë nuk ndalohet që deputetët që kanë kërkuar nisjen e një procedure shkarkimi, të mos jenë edhe anëtarë të komisionit parlamentar. Gjithashtu, në asnjë prej këtyre burimeve nuk ndalohet dhe nuk mund të ndalohet që të lartpërmendurit të mos marrin pjesë në votimin e raportit përfundimtar.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Presidentin e Republikës. Duke qenë organi i vetëm që vendos për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm ai është njëkohësisht i pazëvendësueshëm në këtë vendimmarrje dhe si i tillë në konkurrimin e parimit të ushtrimit të funksionit të organit shtetëror me atë të paanshmërisë, merr përparësi ai i kryerjes së funksionit kushtetues.

33. Nga sa rezulton e provuar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të pabazuara pretendimet e kandidatit z.{...}, se shkarkimi i tij nga funksioni i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë nuk duhet të konsiderohet si “largim nga detyra për shkaqe disiplinore” në kuptim të shkronjës “dh”, të nenit 28 në lidhje me nenin 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe, për pasojë, një rrethanë e tillë nuk duhet të klasifikohet si mospërbushje nga ai të këtij kriteri ligjor kandidimi për gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

34. Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të pabazuar pretendimin e kandidatit z.{...} se akti i shkarkimit të tij nga funksioni i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, pra dekreti i Presidentit të Republikës, nuk duhet të merret parasysh nga Këshilli, përse kohë ai nuk ka patur ligjërish mundësi për ta kundërshtuar atë para një gjykate për bazueshmërinë faktike dhe ligjore të tij, pra në lidhje me themelin.

34.1 Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon se pretendimi i kërkuarit nuk ka asnjë bazë ligjore. Këshilli, sikundër çdo organ tjetër i administratës publike, nuk mund të anashkalojë ekzistencën dhe as të vërë në diskutim vlefshmërinë e një akti juridik administrativ individual të nxjerr nga organi i ngarkuar nga ligji (Kushtetuta në këtë rast) dhe brenda kompetencave të tij, akti i cili është ligjërish në fuqi. Në rastin konkret jemi para një dekreti të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, që është nxjerr brenda kompetencave që Kushteta (sipas rregullimeve të kohës) i ka njohur këtij organi, për më tepër, siç ka pranuar Gjykata Kushtetuese, duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor, esenciale për vlefshmërinë e çdo akti juridik administrativ individual. Këshilli në këtë rast ka detyrimin të pranojë ekzistencën dhe vlefshmërinë e këtij akti juridik, duke e vlerësuar atë në raport dhe brenda kufijve të ushtrimit të funksionit të tij kushtetues, atë të propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, pra në kuadër të verifikimit, sipas ligjit, të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të z.{...}.

34.2 Rrethana e pretenduar nga kandidati, ajo për pamundësinë ligjore (sipas legjisllacionit të kohës) për të kundërshtuar dekretin e shkarkimit nga funksioni i Prokurorit të Përgjithshëm para një gjykate në lidhje me bazueshmërinë faktike dhe ligjore të tij, pra në lidhje me themelin, në

vlerësim të Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk është relevante për të çuar në përfundimin për inekzistencën e këtij akti juridik, sikundër po ashtu një rrethanë e tillë nuk mund të shërbejë as për anashkalimin e tij nga Këshilli apo vënien në diskutim nga ai të vlefshmërisë së aktit juridik në fjalë. Të vepruarit nga Këshilli, sikundër kandidati pretendon, do të thotë që Këshilli t'i japë vetes kompetenca që nuk i ka, pra të tejkalojë kompetencat e tij kushtetues dhe ligjor. Thënë kjo mbahet në konsideratë se pretendimi i kandidatit në thelb konsiston në mohimin, sipas tij, nga rendi juridik, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore, në rastin konkret të të drejtës së ankimit para një gjykate të zakonshme ndaj nje akti juridik administrativ individual. Pra, sipas kandidatit, rendi juridik i kohës nuk i ka siguruar atij të drejtën e një ankimi efektiv në gjykatë. Këshilli çmon se vlerësimi i një pretendimi të tillë kapërcen kompetencat e tij. Nga ana tjetër, çështja ligjore e ngritur nga kandidati është trajtuar nga Gjykata Kushtetuese, e cila në jurisprudencën e saj, përfshirë edhe në vendimin e dhënë mbi ankimin e kandidatit, ka pranuar se *“mbrojtja kushtetuese realizohet në rastin e të gjitha konflikteve që janë vendimtare për pozicionin juridik të një personi, qoftë ai edhe funksion publik, duke e parë funksionin e funksionarit publik në këndvështrimin e garancive që ia siguron Kushtetuta dhe jurisprudenca e kësaj gjykate”*. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese ka pranuar se *“Në rastin e kërkesave kundër vendimit të Kuvendit dhe përkatësisht të dekretit të Presidentit për shkarkimin nga detyra, kërkuessit nuk mund të vënë në lëvizje ndonjë organ tjetër shtetëror për shqyrtimin e tyre veç Gjykatës Kushtetuese, sepse asnjë prej organeve të tjera shtetërore nuk ka në kompetencë shqyrtimin e këtyre kërkesave”* apo se *“dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, si një akt individual me karakter administrativ, nuk mund të trajtohet në të njëjtën mënyrë si aktet e tjera administrative, të cilat shqyrtohen nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm”*. Së fundi, Gjykata Kushtetuese ka pranuar edhe se *“... sipas nenit 149/2 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës është organi që vendos për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm kur arrin në përfundimin se ky i fundit ka shkelur Kushtetutën ose ka bërë shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, ka kryer akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e Prokurorit ose ka paaftësi mendore a fizike. Në këto raste, Presidenti i Republikës, ..., verifikon jo vetëm kushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur për shkarkimin e tyre, por edhe bazueshmërinë në Kushtetutë të shkaqeve të shkarkimeve, pra i futet çështjes në themel. ... Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës në lidhje me interpretimin e bërë në vendimin e saj nr.76, datë 25.04.2002, verifikon pretendimin e individit se gjatë zbatimit të procedurës për shkarkimin e tij nga Kuvendi e Presidenti nuk është respektuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës sipas të cilit, liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të tillë ligjor. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese nuk i hyn themelit të çështjes, pra vlerësimi të shkaqeve të shkarkimit dhe as shfuqizon aktet e Kuvendit e Presidentit për çdo shkelje të procedurave, por i shfuqizon ato vetëm kur konstaton se nuk janë respektuar parimet procedurale në atë masë që të sigurojnë respektimin e së drejtës për një proces të rregullt në kuptimin kushtetues”*.

35. Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të pabazuar edhe pretendimin e kandidatit z. {...}se shkarkimi i tij nga funksioni i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë nuk është bërë për shkaqe disiplinore, por për shkaqe politike dhe natyra e shkarkimit të tij është e njëjtë me atë të “impeachment-it”, ku për këtë arsye ai (dekreti i Presidentit të Republikës) nuk duhet të

merret parasysh nga Këshilli në kuadër të verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit të tij për gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

35.1 Edhe në këtë rast Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon se pretendimi i kërkuesit nuk ka asnjë bazë ligjore. Këshilli çmon se është në kapërcim të kompetencave të tij vënia në diskutim dhe vlerësimi në themel i shkaqeve që kanë çuar në nxjerrjen e një akti juridik administrativ individual, në rastin konkret të propozimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe, më tej, të dekretit të shkarkimit të Presidentit të Republikës. Të dy këto akte, pavarësisht natyrës së këtyre organeve (referuar përbërjes së Kuvendit të Shqipërisë, nga deputetë/funksionarë politike apo mënyrës së zgjedhjes së Presidentit të Republikës, organit që e zgjedh, pikërisht Kuvendi i Shqipërisë i përbërë nga funksionarë politikë), janë nxjerrë në përputhje me procedurat e parapara ligjore, sikurse ka konkluduar Gjykata Kushtetuese, duke përfaqësuar ato ligjërisht shprehjen e vullnetit të këtyre organeve publike, në ushtrimin e funksioneve të tyre publike.

35.2 Në lidhje me shkarkimin e funksionarëve të lartë publik të sistemit të drejtësisë, përfshirë edhe për Prokurorin e Përgjithshëm, legjislacioni i kohës ka parashikuar ndjekjen e një procedurë ligjore, e cila në doktrinë njihet me emrin “*impeachment*”. Në origjinë, “*impeachment*” është procedura që parashikohet si e tillë, pra me këtë togfjalësh, nga Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila ndërmerret nga Dhoma e Përfaqësuesve dhe gjykohet nga Senati, në rast të funksionarëve të lartë shtetërorë, për tradhti, mitmarrje, kryerjen e shkeljeve dhe të veprave penale¹. Qëllimi i “*impeachment*” është të shkarkojë/largojë nga detyra funksionarët e lartë shtetëror dhe vendimmarrja e Senatit² shkon deri tek shkarkimi. “*Impeachment*”, i njohur si i tillë, pra si një procedurë disiplinore që mund të finalizohet me shkarkim, është përhapur me këtë togfjalësh edhe në shumë vende të botës. Kështu, “*impeachment*” njihet si procedurë disiplinore në shumicën e vendeve të Këshillit të Europës.

35.2.1 Konkretisht, në çështjen ***Paksas kundër Lituaniës***, çështja nr.34932/04, datë 06.01.2011 (që ka të bëjë pikërisht me shkarkimin e Presidentit të Lituaniës me procedurë disiplinore (*impeachment*) nga Parlamenti (Seimas), GJEDNJ-ja në Dhomë të Madhe, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “...*Omissis...60. Togfjalëshi "impeachment" nënkupton një procedurë zyrtare akuze me anë të së cilës legjislatura (Kuvendi/Parlamenti) mund të largojë nga detyra një kryetar shteti, një zyrtar të lartë ose një gjykatës, për shkelje të ligjit ose të Kushtetutës. Qëllimi i "impeachment" në parim është që të lejojë fillimin e procedurës penale në gjykata kundër personit në fjalë, por në praktikë nuk prodhon domosdoshmërisht një rezultat të tillë. 61. Sistemet ligjore të shumicës së vendeve anëtare të Këshillit të Europës të cilat kanë një sistem republikan bëjnë parashikime specifike për impeachment-in e kreut të shtetit (Shqipëria, Austria, Azerbajjan, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Lituania, Moldavia, Mali i Zi, Polonia, Rumania, Federata Ruse, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Turqia dhe Ukraina). Procedura "impeachment" mund të ngrihet mbi këto shkaqe (në Lituani, shiko paragrafin 46 sipër); shkelje e Kushtetutës dhe minimi i rendit kushtetues: (Austria, Bullgaria, Kroacia, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Hungaria, oldavia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë); tradhëtia e lartë: (Bullgaria, Qipro, Republika Çeke, Finlanda,*

¹ Neni 1 dhe neni 2 i Kushtetutës.

Franca, Greqia, Italia, Rumania, Federata Ruse); shkelje e ligjit: (Gjermania, HUNgaria); kryerja e një krimi të zakonshëm ose të rëndë: (Finlanda, Federata Ruse); ose sjellje imorale: (Irlanda). 62. Në shumicën e këtyre shteteve, procedimet “impeachment” nuk kanë një efekt direkt mbi të drejtat elektorale dhe politike të Kreut të shtetit, i cili është larguar nga detyra. Megjithatë, në Austri, nëse Presidenti Federal është shkarkuar/larguar nga detyra në bazë të procedimit “impeachment”, Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë kufizimin përkohësisht të të “drejtave politike”, nëse ka shkaqe të rënda. Në mënyrë të ngjashme, në Poloni, gjykata kompetente në këtë rast, përveç shkarkimit të Presidentit nga detyra përkohësisht e kufizon atë nga të drejtat politike (skualifikim i përgjithshëm nga zgjedhjet për një periudhë deri në 10 vjet, ndalimi për të zënë pozicione të caktuara për të njëjtën periudhë dhe revokimi i urdhrave ose i titujve të tjerë honorarë). Në Sllovaki dhe Republikën Çeke, një person i shkarkuar nga posti i presidentit si rezultat i procedurës “impeachment”, në mënyrë të përhershme i ndalohet të konkurojë për President, ose si kandidat në zgjedhjet e tjera; në Federatën Ruse ai ose jo ndalohet që të kandidojë në zgjedhjet që pasojnë shkarkimin e tij/saj nga detyra”.

35.3 Një proces disiplinor ose “impeachment”, i njohur nga edhe nga e drejta shqiptare, është dhe ai për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, sikurse është edhe rasti i z. {...}. Referuar ligjit të kohës (pasi me miratimin e paketës së ligjeve për reformën në drejtësi është ndryshuar Kushtetuta dhe një sërë ligjesh organike të rëndësishme), parashikohet se:

neni 93 i Kushtetutës parashikonte se: *“Presidenti i Republikës, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr dekrete”;*

neni 149 i Kushtetutës parashikonte se: *“... 2.Prokurori i Përgjithshëm mund të shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kuvendit, për shkelje të Kushtetues ose shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Prokurorit”;*

neni 7 i Ligjit 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” parashikonte se: *“1. Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. 2. Prokurori i Përgjithshëm mund të shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Kuvendit për shkelje të Kushtetutës ose për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve, për paaftësi mendore a fizike, për akte sjelljeje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Prokurorit”;*

neni 4 i Ligjit nr.8891, datë 02.05.2002 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit” përcakton se: *1. Komisionet hetimore të Kuvendit ngrihen dhe funksionojnë mbi bazën e parimeve kushtetuese dhe rregullave të përcaktuara në këtë ligj. 2. Rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale për hetimin zbatohen drejtpërdrejt nga komisionet hetimore të Kuvendit, për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe. 3. Vendimi përfundimtar i komisionit hetimor të Kuvendit shoqërohet gjithmonë me mendimin e pakicës dhe shpallet publikisht. 4. Komisionet organizohen dhe funksionojnë, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj....omissis...”*

35.4 Nga sa më lart, shkarkimi i Prokurorit të Përgjithshëm, ndryshe nga sa kandidati pretendon, është një proces disiplinor. Një gjë e tillë është pranuar dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, përfshirë edhe në vendimin e dhënë mbi ankimin e kandidatit. Konkretisht, Gjykata Kushtetuese ka pranuar se *“Nëse ... Prokurori i Përgjithshëm rezulton se ... ka shkelur rëndë*

ligjin, marrja e masës së shkarkimit nga Kuvendi është e lidhur domosdoshmërisht me kryerjen e procedurave përkatëse. Funkzioni që kryen Kuvendi në këtë rast është i një natyre të veçantë. Procesi i realizuar prej Kuvendit ndryshon nga gjithë veprimtaria e tij e zakonshme si një organ që miraton ligje. Ky proces ligjor që është një proces gjykimi disiplinor dhe i ngjashëm me procedurat hetimore administrative ka parimet e veta, të cilat lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e atyre shkaqeve konkretë që kanë shërbyer për organin kompetent për të marrë masën e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit apo prokurorit”. Nisur nga kjo, duke qenë se procesi i shkarkimit nga detyra i Prokurorit të Përgjithshëm është një proces gjykimi disiplinor edhe vendimi (dekreti në rastin konkret) i shkarkimit është i natyrës disiplinore, çka do të thotë se një rrethanë e tillë klasifikohet si “*largim nga detyra për shkaqe disiplinore*” në kuptim të shkronjës “dh”, të nenit 28, të Ligjit nr. 96/2012 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

36. Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të pabazuar edhe pretendimin e kandidatit z. {...} se masa e shkarkimit të tij nga funksioni i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë është parashkruar në kuptim të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

36.1 Në referim të shkronjës “dh”, të nenit 28, të Ligjit nr. 96/2012 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si kriter pranimi të kandidaturës për gjyqtar në Gjykatën e Lartë përcaktohet edhe ai i *disiplinës në detyrë (punë/shërbim) të kandidatit*. Në fakt dispozita në fjalë, në pikëpamje gjuhësore, është formuluar përmes një fjalisë të përbërë, ku dy pjesët e saj janë të pavarura dhe mund të qëndrojnë më vete si fjali të thjeshta. Konkretisht, pjesa e parë e fjalisë përcakton që kandidati “*nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore*”, ndërsa pjesa e dytë e fjalisë përcakton që kandidati “*nuk ka masë disiplinore në fuqi*”. Të dy këto pjesë të rregullit të përcaktuar në këtë dispozitë ligjore në realitet, edhe në pikëpamje të ligjit, përmbajnë dy situata faktike të ndryshme dhe të pavarura, ku sipas të parës kërkohet që kandidati “*mos të jetë i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore*”, ndërsa sipas situatës së dytë kërkohet që kandidati “*mos të ketë masë disiplinore në fuqi*”. Pra, kriteri i disiplinës në detyrë (punë/shërbim) të kandidatit sipas kësaj dispozite ligjore në fakt përmban dy kritere/nënkritere të ndryshme të së njëjtës natyre, pavarësisht se ato janë përfshirë nën të njëjtin rregull. Për këtë mjafton argumenti se nëse të dyja këto kritere do të merreshin së bashku në mënyrë kumulative nën të njëjtin kriter, atëherë ligjvënësi do të ishte mjaftuar me parashkrimin si kriter vetëm atë që kandidati “*nuk ka masë disiplinore në fuqi*”. Megjithatë kjo është një çështje që i takon teknikës legislative të përdorur nga ligjvënësi në rastin në fjalë, ndërkohë që kriteri që paraqet rëndësi në rastin konkret është ai sipas të cilit kandidati “*nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore*”.

36.2 Në kuptim të këtij kriteri individ/juristi i spikatur që konkurren për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nuk duhet të ketë në eksperiencën e tij të punës, jo vetëm masë disiplinore në fuqi, por edhe rekorde historike negative në lidhje me disiplinën në detyrë (punë/shërbim). Ligjvënësi në këtë mënyrë ka synuar që gjyqtari, në veçanti ai i Gjykatës së Lartë, të gëzojë cilësi dhe integritet maksimal të pacënuar gjatë çdo lloj marrëdhënie të mëparshme të punës/shërbimit, pa marrë në konsideratë efektet që krijon instituti i shuarjes së masës disiplinore, duke respektuar parimin “*Legum servi sumus ut liberi esse possimus - Jemi shërbëtorë të ligjit për të qenë të lirë*”.

36.3. Në vlerësim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është e vërtete për sa kandidati pretendon në lidhje me shuarjen e masave disiplinore në kuptim të legjislacionit për nëpunësin civil, ku për çdo nga masat disiplinore, përcaktohet një afat kohor, pas kalimit të të cilit, masa disiplinore e dhënë për nëpunësin civil konsiderohet e shuar nga ligji. Por, në rastin konkret, ndryshe nga sa kandidati indirekt pretendon, nuk jemi para një mase disiplinore të dhënë në zbatim të legjislacionit për nëpunësin civil, prandaj konsiderimi në këtë rast i institutit të shuarjes së masës disiplinore është i pavend. Në rastin konkret, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, që parashikon dhe masën e shkarkimit nga detyra të funksionarëve të lartë të sistemit të drejtësisë, nuk parashikon shuarjen e kësaj mase. Po ashtu, edhe legjislacioni i posaçëm që ka rregulluar përgjegjësinë disiplinore të funksionarëve të sistemit të drejtësisë, prokurorëve apo gjyqtarëve, nuk parashikon shuarjen e masës së shkarkimit të dhënë për ata. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për legjislacionin e posaçëm aktual.

36.4. Nisur nga sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se në rastin e kriterit të përcaktuar në nenin 28, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, qëllimi i ligjvënësit është i qartë, kandidati për gjyqtar, në veçanti ai për në Gjykatën e Lartë, nuk duhet që gjatë gjithë eksperiencës së punës/shërbimit të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Kjo pasi nëse qëllimi i ligjvënësit do të ishte i ndryshëm, atëherë nuk do të ishte bërë ky parashikim ligjor. Nëse qëllimi i ligjvënësit është që si kriter ndalues të përbëjë vetëm fakti që masa disiplinore e marrë të mos jetë e shuar, Këshilli vlerëson se ligjvënësi do të ishte mjaftuar me parashikimin e kriterit “*nuk ka masë disiplinore në fuqi*”, ku kjo e fundit përfshin, përveç masave të tjera, edhe atë të “largimit nga detyra”. Pra, ligjvënësi nuk do t’i ndante këto dy kritere por do të mjaftohej me faktin që kandidati për anëtar në Gjykatën e Lartë të mos kishte masë disiplinore në fuqi (*ku logjikisht përfshihet edhe masa më ekstreme, ajo e shkarkimit nga detyra*).

36.5. I njëjti paralelizëm mund të bëhet edhe me rregullin e parashikuar në shkronjën “d”, të nenit 28, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku si kriter ndalues është parashikuar qenia e kandidatit i dënues me vendim penal të formës së prerë. Pavarësisht se dënimi penal mund të jetë ekzekutuar, e të kenë kaluar edhe aftet e shuarjes së dënimit, për t’u konsideruar personi i rehabilituar, ky individ nuk mund të kualifikohet si kandidat për gjyqtar. Qëllimi është i qartë, për këtë kategori funksionarësh publike kërkohet një nivel i tillë integriteti moral, që nuk duhet të jenë të penalizuar ndonjëherë nga organi kompetent për shkelje penale, pasi kjo kategori funksionarësh publik duhet të transmetojë vlera dhe arritje të tilla, jo vetëm në një moment të caktuar, por gjatë gjithë jetës.

36.6 Për rrjedhojë, kandidatët për gjyqtarë, për shkak të funksionit që kërkojnë të emërohen, nuk mund të mbajnë mbi supë qoftë edhe një masë largimi nga detyra për shkaqe disiplinore, pasi imazhi që ata duhet të reflektojnë para publikut duhet të jetë i atillë që të garantojë ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në process, që përcaktohet një nga vlerat themelore të sistemit të drejtësisë sipas nenit 3 të , të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. KONKLUZIONE

37. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidati, z. {...}, nuk plotëson kushtin e kandidimit për në Gjykatën e Lartë, atë të “nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, prandaj Këshilli është përpara rastit për të vendosur skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë ku ai ka konkuruar.

38. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson po ashtu se në rastin konkret nuk është e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit për këtë kandidat, përsa kohë, sipas ligjit, mosplotësimi edhe i një kushti të vetëm këndimi pasjellë skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 1 dhe 2, shkronja “a”, të nenit 49 në lidhje me shkronjën “dh”, të nenit 28, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në shkronjën “c”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “ë”, të nenit 86 dhe nenet 97, 98 dhe 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “e”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.108, nr.109, nr.110, datë 09.07.2019 dhe Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR